



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.5.2023

Nr: 540

Ora: 19:00

VENDIM
PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
KORÇË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 73 dhe ZAZ nr. 74.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Korçë, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë.

Data: 20.5.2023 Nr: 540
Ora: 19:00



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 73 dhe KZAZ nr. 74 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Korçë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës Zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Korçë, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 73 dhe ZAZ nr. 74, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë, Qarku Korçë, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Korçë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Sotiraq Filo si Kryetar i Bashkisë Korçë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 20.5.2023 Nr: 540
Ora: 19:00



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA KORÇË, QARKU KORÇË



Lidhja 1

		ZAZ 73	ZAZ 74	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	34.232	75.345	109.577
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	11.877	24.237	36.114
3	Vota të pavlefshme	307	1.051	1.358
4	Vota të vlefshme	11.537	23.144	34.681
5	Flete votimi te hedhura gabim	33	42	75
1	Ledina Bardhyl Alolli	4.395	9.257	13.652
2	Sotiraq Melka Filo	7.142	13.887	21.029
Totali i votave të vlefshme		11.537	23.144	34.681



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA KORÇË, QARKU KORÇË

Lidhja 2



		ZAZ 73	ZAZ 74	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	34.232	75.345	109.577
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	11.865	24.290	36.155
3	Vota të pavlefshme	416	861	1.277
4	Vota të vlefshme	11.427	23.388	34.815
5	Flete votimi te hedhura gabim	22	41	63
1	Bashkë Fitojmë	2.309	4.778	7087
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	5.879	11.114	16993
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	355	1.151	1506
4	Partia Republikane Shqiptare	423	931	1354
5	Partia Levizja e Legalitetit	32	32	64
6	Partia Demokracia Sociale	64	162	226
8	Partia Socialdemokrate	641	680	1321
9	Partia Demokratike	590	1.281	1871
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	81	303	384
11	Fryma e Re Demokratike	174	385	559
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	48	139	187
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	477	292	769
23	Partia e Gjelbër	187	517	704
35	Nisma Thurje	108	869	977
41	Lazjon Vangjel Petri	59	754	813
	Totali i votave të vlefshme	11.427	23.388	34.815